



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Skupstina Opstine
Municipal Istog

Drejtoria për Arsim

05.Nr. 404/19

Datë: 24.06.2019

Duke vepruar sipas shkresës Nr. ref.3-2231 të MASHT-it të datës 17.06.2019, e në bazë të Ligjin Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, e në lidhje me Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 për Numrin maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, e në mbështetje të Kornizës së Kurrikulit të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog, shpall:

K O N K U R S

Për regjistrim të nxënësve në klasat e dhjeta, viti shkollor 2019/2020, në Gjimnazin "Haxhi Zeka" në Istog, në shkollën e mesme teknike "Mithat Frashëri" Gurrakoc dhe për kandidatët e intresuar në Qendrën Korrektuese në Dubravë, paralelja e SHMT-së "Rudina" Burgu i Dubravës.

Në klasën e dhjetë, në Gjimnazin "Haxhi Zeka" në Istog, sipas planit të regjistrimit për vitin shkollor 2019/2020, mund të regjistrohen 352 nxënës që do të shpërndahen në 11 paralele.

- a) Në drejtimin e shkencave natyrore 7 (shtatë) paralele, 224 nxënës,
- b) Në drejtimin e shkencave shoqërore 4 (katër) paralele, 128 nxënës.

Në shkollën e mesme teknike "Mithat Frashëri" në Gurrakoc, sipas planit të regjistrimit për vitin shkollor 2019/2020, mund të regjistrohen 401 nxënës që do të shpërndahen në 11 paralele.

- a) Makineri - profilet : Operator prodhimi, 2 (dy) paralele, 64 nxënës,
Automekanik....., 1 (një) paralele, 28 nxënës
Metalpunues....., 1 (një) paralele, 28 nxënës
Mekatronike.....1 (një) paralele 28 nxënës
Instalues i ngrohjes.,1 (një) paralele, 28 nxënës
- b).Elektroteknikë-profilet: Informatikë.....,2 (dy) paralele, 64 nxënës
Energjitike.....,1 (një) paralele, 32 nxënës
Instalues elektrik.....,1 (një) paralele, 28 nxënës
- c).Ndërtimtari- profilet : Ndërtimtari.....,1 (një) paralele, 28 nxënës.
- d).Bujqësi-profil: Pemtari- Vreshtari1 (një) paralele, 28 nxënës.
- e).Mjekësi-profil:Infermeri i/e Përgjithshme...1 (një) paralele,32 nxënës.

Në SHMT -Paralelja "Rudina" në Burgun e Dubravës, planifikohet regjistrimi i kandidatëve nga kjo qendër korrektuese, gjithsejtë 45 kandidatë.

a) Makinerei – Profilet :

Saldator..... 1 (një) paralele 15 nxënës

Automekanik..... 1 (një) paralele 15 nxënës

Instalues i ngrohjes... 1 (një) paralele 15 nxënës.

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt.

a) Për regjistrim në klasën e dhjetë (10) të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale për vitin shkollor 2019/2020 mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

b) Nxënësit të cilët e kanë mbaruar kl.9 jashtë Republikës së Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

a) Nxënësit, për të konkuruar për regjistrim në klasën e 10-të të gjimnazeve dhe shkolla profesionale, duhet paraqitur këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesa origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikata e lindjes.

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

a). Paraqitja e dokumenteve për regjistrim në gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2019/2020, bëhet në shkollat përkatëse me datën : **24,25,dhe 26 qershor 2019**, nga ora 8.00 deri në orën 16.00, në lokalet e shkollave amë, ku nxënësit dëshirojnë të regjistrohen e që i plotësojnë kushtet për regjistrim.

b). Rezultatet e pranimit shpallen në shkollat përkatëse me datën: 28.06.2019

c). Kthimi i dokumenteve ,nxënësve që nuk janë pranuar bëhet me 01.07.2019

d). Kandidatet e refuzuar të cilët mendojnë (dyshojnë) që i janë shkelur kriterët e regjistrimit, kanë të drejtë ankese brenda 24 orëve, nga momenti i shpalljes së rezultateve të paraqesin:

e). Ankesa me shkrim i Drejtohet drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit e në raste të jashtëzakonshme edhe Ministrisë Arsimit, Shkencës dhe Teknologjis-komisionit për ankesa.

4. Kriterët për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në kl.10 duhet t'i plotësojë këto kriterë:

1. Sukses nga shkollimi i obliguar..... 25 % 25 pikë

2. Sukses nga lëndët prioritare në test..... 15% 15 pikë

3. Numri i përgjithshëm i pikëve nga testi..... 60% 60 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitoj 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjeksisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4 (Së pari gjindet mesatarja e lëndëve veq e veq pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndve).

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë.

1.Nxënësit nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligushëm(kl.6,7,8,9) mund t'i fitojnë maksimalisht 25 pikë.

Formula për llogaritje e pikve të suksesit është:

$$\frac{\text{Suksesi (kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9)}}{4} \times 5 = 25$$

2. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 15 pikë (psh 3 lëndë të profilit të caktuar shumëzohet më mesatarene notave të kl. 6 - 9 të (5+5+5+5) = 20; 20 : 4 = 5)

$$\frac{\text{mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II) + mesatarja e lëndës (III)}}{3} \times 3 = 15 \text{ pikë}$$

Kur në profilin e caktuar kërkohen vetëm dy lëndë në këtë rast vlera e fituar pjestohet me 2 dhe shumëzohet 3.

$$\frac{\text{mesatarja e lëndës (I) + mesatarja e lëndës (II)}}{2} \times 3 = 15 \text{ pikë}$$

Në rast se kemi 5 lëndë prap mbledhen mesataret e 5 lëndëve pjestohen me 5 dhe shumëzohen me 3.

3.Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

Gjimnazi i shkencave natyrore - Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji),ky kriter vlen edhe për të gjitha profilet e shkollës së mjeksisë.

p.sh për tri lëndë:

$$\frac{\text{Kimi (3) + Biologji (4) + Fizikë (5)}}{3} = \frac{3+4+5}{3} = \frac{12}{3} = 4$$

Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore - Mesatarja e lëndëve: gjuhë shqipë, gjuhë angleze ,histori, gjeografi, edukatë qytetare së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët gjuhë shqipë, gjuhë angleze histori dhe gjeografi).

për 5 lëndë:

$$\frac{\text{mes.gj.amtare + mes.gj.angleze + mes.his + mes.gjeog + mes.ed.qytet.}}{5} \times 3 = 15$$

B. Përmbajtja e testit – numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve:

I Gjuhë

- | | |
|--------------------|---------|
| 1.Gjuhë shqipe | 20 pikë |
| 2.Gjuhë angleze | 5 pikë |
| (Gjithsej 25 pikë) | |

II.Shkenca Shoqërore

- | | |
|--------------------|---------|
| 1. Gjografi | 12 pikë |
| 2. Histori | 13 pikë |
| (Gjithsej 25 pikë) | |

III.Matematikë

- | | |
|--------------------|---------|
| 1. Matematikë | 20 pikë |
| 2 .Informatikë | 5 pikë |
| (Gjithsej 25 pikë) | |

IV. Shkencat natyrore:

- | | |
|--------------------|--------|
| 1 Fizikë | 9 pikë |
| 2. Kimi | 8 pikë |
| 3. Biologji | 8 pikë |
| (Gjithsej 25 pikë) | |

4. Renditja e lëndëve me prioritet sipas drejtimeve të gjimnazeve:

I.Gjimnazi shkencat e natyrës:

- | | | |
|-----------------------------------|----|---------------------------|
| 1. Shkencat e natyrës | 25 | $25 \times 1.2 = 30$ pikë |
| 2. Matematikë dhe informatikë | 25 | $25 \times 0.6 = 15$ pikë |
| 3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze | 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 4. Shkencat shoqërore | 25 | $25 \times 0.2 = 5$ pikë |
| | | Totali = 60 pikë |

II. Gjimnazi shoqëror gjuhësor

- | | | |
|--|----|----------------------------|
| 1.Gjuhë amtare,gjuhë angleze dhe shkenca shoqërore | 50 | $50 \times 0.9 = 45$.pikë |
| 2.Matematikë dhe Informatik | 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 4.Shkenca natyrore | 25 | $25 \times 0.2 = 5$ pikë |
| | | Totali = 60 pikë |

5.Renditja e lëndëve me prioritet sipas profileve në shkolla profesionale

I.Shëndetsi ,Bujqësi dhe Vetrinari

- | | | |
|----------------------------------|----|---------------------------|
| 1.Shkenca natyrore | 25 | $25 \times 1.2 = 30$ pikë |
| 2.Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze | 25 | $25 \times 0.6 = 15$ pikë |
| 3.Matematikë dhe Informatikë | 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 4.Shkenca Shoqërore | 25 | $25 \times 0.2 = 5$ pikë |
| | | Totali = 60 pikë |

II. Makineri, Elektroteknikë, Gjodezi, Ndërtimtari, Xehtari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi - Teknologji

1. Matematikë dhe Informatikë	25	$25 \times 1.2 = 30$ pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze	25	$25 \times 0.6 = 15$ pikë
3. Shkenca natyrore	25	$25 \times 0.4 = 10$ pikë
4. Shkenca shoqërore	25	$25 \times 0.2 = 5$ pikë
		Totali = 60 pikë

III. Ekonomi

1. Matematikë dhe informatikë	25	$25 \times 1.2 = 30$ pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze	25	$25 \times 0.6 = 15$ pikë
3. Shkenca shoqërore	25	$25 \times 0.4 = 10$ pikë
4. Shkencat natyrore	25	$25 \times 0.2 = 5$ pikë
		Totali = 60 pikë

IV. Juridik

1. Shkenca shoqërore	25	$25 \times 1.2 = 30$ pikë
2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze	25	$25 \times 0.6 = 15$ pikë
3. Matematikë dhe informatikë	25	$25 \times 0.4 = 10$ pikë
4. Shkencat natyrore	25	$25 \times 0.2 = 5$ pikë
		Totali = 60 pikë

V. Tregti, Hoteleri dhe Turizem

1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze	25	$25 \times 1.2 = 30$ pikë
2. Shkenca shoqërore	25	$25 \times 0.6 = 15$ pikë
3. Matematikë dhe informatikë	25	$25 \times 0.4 = 10$ pikë
4. Shkencat natyrore	25	$25 \times 0.2 = 5$ pikë
		Totali = 60 pikë

VI. Shkollat Artistike

1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze	25	$25 \times 1.2 = 30$ pikë
2. Shkenca shoqërore	25	$25 \times 0.6 = 15$ pikë
3. Matematikë dhe Informatikë	25	$25 \times 0.4 = 10$ pikë
4. Shkencat natyrore	25	$25 \times 0.2 = 5$ pikë
		Totali = 60 pikë

VII. Kriteret specifike për regjistrimin në shkolla të muzikës

a. Drejtimi pedagogjik – profili bashkëpunëtor muzikor:

Nxënësi duhet ta ketë përfunduar shkollimin e obliguar (kl.IX) dhe testin kombëtar:

b. Drejtimi instrumental:

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl.IX) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VII)

c. Në klasën e VII të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VI)

e. Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë – duhet t'i nënshtrohen provimit pranë komisioni i shkollës

Istog, 24.06.2019

Drejtori i DKA-së
Hajrush Shoshi